



## **V E N D I M**

**Nr. 585, datë 22. 07. 2020**

### **PËR**

### **MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR DIASPORËN DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT 2021–2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave,

### **V E N D O S I:**

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe të planit të veprimit 2021-2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi nr.259, datë 9.5.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024 dhe të planit të veprimit”, shfuqizohet.
3. Ngarkohen të gjitha ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore, për të cilat në strategji dhe në planin e veprimit janë përcaktuar detyra të veçanta, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2021 dhe deri në këtë datë do të zbatohet vendimi nr.259, datë 9.5.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024 dhe të planit të veprimit”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**